



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika (d), lidhur me nenin 40 paragrafi 2, pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 45 paragrafi 4, lidhur me nenin 46 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-048, për menaxhimin e financave publike te përgjithshme, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008”, e konform nenit 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miratoi këtë;

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet raporti financiar i ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2024.

Neni 2

Pjesë përbërës e këtij vendimi është edhe raporti financiar i ekzekutimit dhe i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2024, me numër te protokollit 01-Nr-052-3185, të datës 14.01.2025, i hartuar nga Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet e Komunës së Suharekës.

Neni 3

Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoret e Drejtorive dhe Kryetari i Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI